REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 154/11 Prot. Tiranë, më 28.10.2019

(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: **Njoftim për vend të lirë pune**

DREJTUAR: **AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK**

TIRANË

Në zbatim të Vendimit Nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave (VKM) "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë" (i ndryshuar), Urdhërin e Kryeministrit Nr. 171 datë 27.09.2010 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë", dhe VKM Nr.143 datë 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për **1 (një)** vend të lirë pune në pozicionin e **Specialistit pranë Sektorit të Statistikave dhe Analizave.**

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të, me formim Informatikë ose Teknologji Informacioni;
2. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në profesion që ka lidhje me pozicionin e shpallur, si dhe kandidatët që kanë përvojë pune në arsimin e lartë ose që kanë lidhje me arsimin e lartë;
3. Të zotërojë gjuhën angleze, të çertifikuar në një nga testet ndërkombëtare të njohura nga MASR, me dëshmi në nivel mbi mesataren;
4. Të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike në programet bazë dhe të avancuara të sistemeve të menaxhimit të informacionit si dhe të njohë programet dhe metodat e analizave dhe studimeve statistikore;
2. Të ketë eksperiencë pune të paktën 5 (pesë) vjeçare në institucione publike në fushën e administrimit dhe përpunimit të të dhënave dhe administrimit të sistemeve të IT;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail:info@ascal.al

3. Preferohen kandidatë që kanë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë dhe njohuri mbi institucionet, programet e studimit, procedurat, kriteret dhe aktet nënligjore të sistemit të akreditimit;
4. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese;
5. Të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*);
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal;
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar;
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces;
5. Fotokopjen e librezës së punës, e noterizuar;
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj, e noterizuar;
7. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të kryera, të noterizuara;
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm;
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkruar dhe folur, edhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 08.11.2019, ora 10:00 në adresën e mëposhtme:

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit "Qemal Stafa"
Tel: 4 22 43 423

Mund të aplikojnë për këtë pozicion pune edhe personat që janë pjesë e stafit të ASCAL. Për këta kandidatë kërkohet plotësimi i dokumentacionit sipas pikës III ose përditësimi i atyre ekzistuese.

- Njoftimi të bëhet edhe në web site të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë:

  www.ascal.al

DREJTORI

Elvin Gjevori

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË TIRANË